



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 6735 Prot.

Tiranë, më 28 . 9 . 2017

URDHËR
Nr. 292, datë 28-9 . 2017

PËR
MIRATIMIN E SUPPLEMENTIT TË TRASHËGIMISË BOTËRORE TË PLANIT TË
MENAXHIMIT TË
'PEIZAZHIT TË MBROJTUR UJOR/TOKËSOR POGRADEC'

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit nr.81/2017, "Për zonat e mbrojtura",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Supplementit të Trashëgimisë Botërore të Planit të Menaxhimit të "Peizazhit të mbrojtur uhor/tokësor Pogradec", të përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës në kuadër të projektit IPA ndërkufitar "Drejt forcimit të qeverisjes së trashëgimisë së përbashkët natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të liqenit të Ohrit", të financuar nga Bashkimi Evropian, sipas tekstit bashkëlidhur,
2. Supplementi i Trashëgimisë Botërore të Planit të Menaxhimit të "Peizazhit të mbrojtur uhor/tokësor Pogradec" është pjesë përbërëse integrale e planit të menaxhimit të Peizazhit të mbrojtur uhor/tokësor Pogradec, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr. 2026, datë 31.12.2014 "Për miratimin e planit të menaxhimit të peizazhit të mbrojtur uhor/tokësor Pogradec".
3. Për zbatimin e Planit të Menaxhimit ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ministria e Kulturës, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Inspektoriat i Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia Pogradec dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse të përfshira dhe palët e tjera të interesuara.

4. Për të mbikqyrur zbatimin e Suplementit të Trashëgimisë Botërore të Planit të Menaxhimit të “Peizazhit të mbrojtur Pogradec” ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur.
5. Bazuar në dispozitat e ligjit “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, Suplementi i Trashëgimisë Botërore të Planit të Menaxhimit të “Peizazhit të mbrojtur ujor/tokësor Pogradec” të përfshihet dhe të integrohet në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë që lidhen me to si dhe në vendimmarrjet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
6. Suplementi i Trashëgimisë Botërore të Planit të Menaxhimit të “Peizazhit të mbrojtur ujor/tokësor Pogradec”, të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mjedisit.
7. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të “Peizazhit të mbrojtur ujor/tokësor Pogradec”, Ministria e Mjedisit, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektoriat i Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LEFTER KOKA

MINISTËR

